



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 060/01-8988/2026  
Kaçanik, 30.04.2026

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV (katërt)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2026 (Legjislatura e 8), mbajtur me 30.04.2026 (e enjte), në katin e tretë, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga Kuvendi i Komunës, pjesëmarrës në mbledhje janë 21 anëtarë-të gjithë (lista i bashkëngjitet procesverbalit). Nga Ekzekutivi i komunës morën pjesë: Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Nënkryetari i Komunës - Xhelal Dema, drejtorët e drejtorive: Korab Krasniqi-DUKMM, Valdrin Dogani-DBF, Arian Teneqja-DSHPE, Suhad Dullovi-DBPZHR, Urata Sopa-DAP, Lumnije Demnika Selmani-DSHMS, Arlinda Rakoci Raka-DZHET, Gazmend Bunjaku-DA, Lulzim Krasniqi-DKRS. Nga zyrtarët: Zyrtarja për Informim, Zyrtari i IT, Zyrtarja e KK, Asistentja e Kryesuesit.

Mbledhja monitorohet nga distanca nga zyrtari i MAPL, Nehat Uka. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu-Zyrtar i lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit - Selajdin Troni:** Së pari i përshëndeti të gjithë të pranishmit, iu dëshiroi mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur me emër, prezentë janë të gjithë, kushtet pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e IV-të të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2026 të Legjislaturës së 8, data 30.04.2026, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2026;
3. Propozim Vendim për themelimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusave" SH.A.- Kaçanik;
4. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik i Vjetër;
5. Propozim Vendim për Plotësim Ndryshimin e Vendimit 01Nr. 104/02-4196/26 të datës 26.02.2026, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Faik (Rufat) Muça.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin, por nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 21. Konstatohet se Kuvendi i Komunës,

**Aprovoj**

**Rendin e punës në përbërje prej 5 pikave.**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;  
Procesverbalit i mbledhjes së kaluar të KK u aprovua njëzëri. Prezentë 21. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

### APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja III (tretë) e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2026, të datës 30.03.2026/ Lënda: 01Nr.060/01-6490/2026.

### Pyetjet dhe Kërkesat

**z. Jeton Luma:** 1. Transporti i nxënësve në f. Gllloboçicë: Arsimi është e drejtë themelore dhe shkollimi fillor është i detyrueshëm me ligj në Republikën e Kosovës. Kur shteti e obligon shkollimin, institucionet komunale kanë për detyrë të sigurojnë qasje, ku transporti është element kyç. Në fshatin Gllloboçicë, në lagjet Kodrali dhe Dragomas, 19 nxënës udhëtojnë çdo ditë diku 4 km apo me tepër për të ndjekur mësimin. Për vite me radhë, prindërit kanë mbuluar vetë shpenzimet e transportit, gjë që përbën barrë të rëndë, sidomos duke qenë se shumë prej tyre janë raste sociale. Kërkoj që komuna të marrë përgjegjësinë ligjore dhe të sigurojë transportin për këta nxënës, pasi kjo është një e drejtë bazike dhe e domosdoshme.

2. Menaxhimi i zonës turistike në f. Strazhë (1 Maji): Fshati Strazhë, si zonë turistike, pritet të ketë fluks të madh vizitorësh gjatë festës së 1 Majit. Është e nevojshme të merren masa për garantimin e rendit, sigurisë dhe mbrojtjes së pronës publike dhe private. Po ashtu, kërkoj organizim për pastrimin e zonës pas festës, për të shmangur ndotjen dhe rreziqet e mundshme, si zjarret nga mbeturinat.

3. Ndriçimi publik në f. Gllloboçicë. Edhe pse disa shtylla janë rregulluar, një pjesë e ndriçimit publik mbetet jashtë funksionit, veçanërisht përgjatë rrugës "Batalioni III". Kërkoj të bëhet riparimi i plotë të ndriçimit në këtë zonë.

**z. Bashkim Krasniqi:** Unë i kam tri kërkesa të qytetarëve

1. Nga banorët e f. Begracë, kërkohet ndërtimi i një rreth rrotullimi në mes të shkollës dhe xhamisë, pasi zona frekuentohet nga nxënësit dhe paraqet nevojë për rritjen e sigurisë në komunikacion.

2. Banorët e f. Begracë kërkojnë që komuna të rregullojë hapësirën e ndarë për varreza, pasi lokacioni tashmë është përcaktuar.

3. Kërkesa tjetër është, Kyçja në rrugën te Varrezat e Dëshmorëve nga drejtimet Kaçanik i Vjetër, Stagovë dhe Dubravë paraqet rrezik të madh. Edhe pse janë krijuar rrugë alternative, kërkohet që komuna të bëjë një Kërkesë zyrtare në Ministrinë e Infrastrukturës për një zgjidhje më të sigurt, si ndërtimi i rreth rrotullimit, nënkalimit apo mbikalimit.

**znj. Ardita Rrahmani:** Pas konsultimeve me qytetarë dhe shqyrtimit të kërkesave të tyre, parashtroj këto pyetje dhe kërkesa:

1. E ri përsëris kërkesën për shtimin e kamerave të sigurisë në zonat me dukshmëri të ulët, si në qytet ashtu edhe në fshatrat përreth. Duke qenë se komuna është përgjegjëse për

infrastrukturën, ndërsa menaxhimi dhe mbikëqyrja bëhen nga Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht policia, kërkoj që kjo çështje të trajtohet me prioritet.

2.Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike: kërkohet mirëmbajtja e trotuareve dhe rregullimi i ndriçimit publik të dëmtuar në zonat urbane dhe rurale.

3.A janë zhvilluar kohët e fundit takime me kompaninë e ujësjellësit “Bifurkacioni” për të adresuar problemet me furnizimin me ujë të pijshëm gjatë sezonit veror? Në takimin e fundit (ku kam qenë edhe unë e pranishme), është premtuar përmirësim i situatës.

4.Për Drejtorinë e Urbanizmit: kur pritet të fillojë sanimi i kubëzave në rrugën “Ismail Qemali”?

5.Pas shpalljes së rrugës me interes publik, kur do të fillojë lidhja infrastrukturore ndërmjet lagjes së Çakëve dhe qytetit?

6.Në lidhje me vijën kufizuese ndërmjet komunave të Kaçanikut dhe Ferizajt: a është sqaruar përfundimisht vendndodhja e saj? Së fundmi është vendosur një shenjë përtej restorantit “Evropa 92”, e cila, sipas njohurive të mia, nuk përputhet me kufirin real. A keni pasur konsultim me Komunën e Ferizajt për këtë çështje?

**z. Islam Gashi:** 1. Kërkesa e parë lidhet me ndërtimin e parkut në fshatin Begracë, i cili ka filluar vitin e kaluar, por që nga muaji dhjetor nuk është vërejtur asnjë progres në punime. Kërkojmë të na informoni për arsyet e ndërprerjes së punimeve, kohën e planifikuar për rifillim, si dhe nëse ekziston një afat i përcaktuar për përfundimin e projektit.

2. Kërkesa e dytë paraqitet në emër të banorëve të disa lagjeve në fshatin Begracë dhe ka të bëjë me kanalizimin fekal. Megjithëse rrjeti i kanalizimit është ndërtuar në pjesën më të madhe të fshatit, disa shtëpi ende nuk janë të kyçura në rrjetin kryesor. Duke marrë parasysh këtë situatë, kërkojmë që të shqyrtohet mundësia e kyçjes së këtyre shtëpive, me qëllim të parandalimit të kundërmimit dhe përmirësimit të kushteve të jetesës së banorëve.

**z. Hestet Malsiu:** 1. Kërkoj që zona e Shtrezovicës të shpallet me interes publik për ndërtimin e një parku rekreativ, i cili do të përfshijë shtigje ecjeje dhe fusha sportive (tenis, pingpong dhe futboll). Ky park do të shërbejë për fshatrat Biçec, Nikë, Rekë, Dubravë, Vatë dhe Soponicë, pa nevojë për përdorim të automjeteve, si dhe për të gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut. Kjo kërkesë bazohet edhe në rëndësinë historike të kësaj zone, si vend i ngjarjeve të 25 majit në rajonin e Kaçanikut, ku janë shpëtuar shumë jetë, ndaj vlerësoj se meriton trajtim të veçantë publik.

2.Nga sugjerimet e shefit të grupit të PDK-së për dalje në terren, vizitua Begracën dhe konstatua se ndërtimi i parkut ka sjellë përmirësim urbanistik, por njëkohësisht ka bllokuar një rrugë lokale të fshatit. Kërkojmë që kjo çështje të shqyrtohet dhe të gjendet një zgjidhje adekuate.

**z. Kjani Zeneli:** E kam vetëm një kërkesë. Se pari e përgëzoj komunën për heqjen e deponive ilegale, ndërkaq një deponi është lënë në harresë. Nuk e di a e ka paraqitur administratori i fshatit tonë, deponia është në rrugën Voskopja në lagjen Zeneli-përballë

shtëpisë së Shaip Zeneli. Ajo deponi kundërmon shumë erë dhe ka shumë materiale të këqija aty. Është mirë të merret parasysh pastrimi i kësaj deponie.

**znj. Ernesta Krasniqi:** I Edhe kërkesa ime ka të bëjë me deponitë ilegale që i përmendi edhe kolegu. Përpos asaj që përmendi kolegu, me intereson të di sesi është bërë pastrimi i deponive, a ka pasur ndonjë pikë grumbullimi, apo vetëm janë mbuluar me dhe?

2. Në rrugën “Komandant Bardhi” në Kaçanik të Vjetër, ndriçimi publik ka kohë që nuk punon deri të shkolla “Qamil Ilazi”. Po besoj se është ndonjë defekt, pasi që pjesa tjetër e ndriçimit publik përgjatë rrugës funksionon. Kërkoj nga drejtoria përkatëse të del në vendngjarje, dhe të merr veprimet e nevojshme për rregullimin e ndriçimit publik në atë pjesë.

**z. Buletin Guri:** Sot i paraqes dy kërkesa dhe një pyetje për kryetarin e komunës:

1. Kërkesa e parë lidhet me banorët e f. Nikaj dhe nevojën urgjente për ndërtimin e një terreni sportiv. Përkundër mungesës së kushteve bazë, ky fshat ka një traditë të vazhdueshme në organizimin e turnirëve të futbollit, çka dëshmon përkushtimin dhe energjinë e të rinjve për aktivitete sportive dhe shoqërore. Është e papranueshme që në vitin 2026 një komunitet kaq aktiv ende nuk ka terren sportiv. Prandaj, kërkoj që ky projekt të trajtohet me prioritet.

2. Kërkesa e dytë ka të bëjë me ndriçimin publik në disa pjesë të f. Nikaj, i cili nuk është funksional. Kjo krijon pasiguri për qytetarët dhe vështirëson lëvizjen gjatë natës. Kërkoj nga Drejtoria për Shërbime Publike që të bëjë një kontroll të përgjithshëm dhe të ndërmarrë masa për rregullimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit.

3. Pyetje për kryetarin: Lidhur me rrugët e dëmtuara nga vërshimet në f. Provoli, çështje e adresuar edhe më herët, por pa veprime konkrete - kur pritet të bëhet rregullimi i rrugëve “Arrëza” dhe “Lunas”?

**znj. Kadrije Lika Troni:** I kam dy pyetje: 1. Pyetje për Drejtorin e Financave- Lidhur me shpërndarjen e bursave për vitin 2025, ka mospërputhje në të dhënat në faqen zyrtare figurojnë 50 përfitues, shifër e konfirmuar edhe nga kryetari, ndërkaq drejtori i drejtorisë së Arsimit në përgjigjën e pyetjes sime ka konfirmuar se janë ndarë 45 bursa, ndërsa ju keni deklaruar 46 bursa (një pas afatit). Kërkoj sqarim: Në çfarë rrethanash është shtuar bursa e 46-të? Pse ende nuk është dorëzuar lista me 46 përfitues që keni premtuar? Pse ka mospërputhje ndërmjet dokumenteve zyrtare dhe deklaratave tuaja?

2. Pyetja e dytë është për Drejtorinë e Urbanizmit- Lidhur me gjendjen e rrugës “Mynyr Thaqi” në f. Kovaçec, nga objekti i Pastërtisë - kryqëzimi me rrugën “Izahir Troni”, është e dëmtuar, me gropa të shumta, gjë që pengon qarkullimin e lirë të qytetarëve, mungon trotuari dhe ndriçimi publik, duke rrezikuar sigurinë e banorëve. Në afërsi të pllakës së dëshmorëve kalon një përrua, pa mbrojtëse anësore, që paraqet rrezik të shtuar për këmbësorët dhe automjetet. Kërkoj nga ekzekutivi, të planifikojë rehabilitimin e rrugës, ndërtimin e trotuarit dhe ndriçimin publik, vendosjen e mbrojtësve anësore përgjatë përroit dhe të sqarojë afatin kohor për realizimin e këtyre ndërhyrjeve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pyetje e kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën e dytë:

2. Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2026;

Para se me hapur diskutimin, fjalën ia kaloj drejtorit të DBF-Valdrin Dogani.

**z. Valdrin Dogani:** Sot para jush paraqesim raportin financiar tremujor të Komunës së Kaçanikut për periudhën 1 janar – 31 mars 2026, të përgatitur në përputhje me obligimet ligjore që rrjedhin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Raporti synon të informojë në mënyrë të qartë dhe transparente mbi realizimin e të hyrave, shpenzimeve dhe investimeve kapitale gjatë TMI 2026. Realizimi buxhetor është zhvilluar në rrethana specifike, pasi Ligji për Ndarjet Buxhetore 2026 ka hyrë në fuqi më 2 mars 2026. Për këtë arsye, komuna ka operuar me regjimin e përkohshëm financiar, respektivisht me 1/12 e buxhetit të vitit paraprak për muajt janar, shkurt dhe mars. Kjo ka ndikuar në dinamikën e alokimeve dhe realizimin e investimeve kapitale. Megjithatë, komuna ka ruajtur stabilitetin financiar dhe ka siguruar funksionimin e rregullt të shërbimeve për qytetarët. Buxheti për vitin 2026 është 13.4 milionë euro, ndërsa gjatë TMI janë shpenzuar rreth 3.2 milionë euro, ose 24.53% e buxhetit total. Krahasuar me vitin 2025, shpenzimet janë rritur për rreth 663 mijë euro. Të hyrat vetjake komunale janë planifikuar në vlerë prej 1.06 milion euro, ndërsa realizimi ka arritur afër 200 mijë euro, ose 18.69% të planit vjetor. Krahasuar me vitin 2025, të hyrat vetjake janë rritur për rreth 15 mijë euro. Realizimi më i ulët i tatimit në pronë gjatë këtij tremujori lidhet me faktin se faturat për vitin tatimor 2026 nuk kanë qenë të qasshme deri më 31 mars dhe kanë filluar të gjenerohen nga 01.04.2026. Për këtë arsye, priten rezultate më pozitive në TM2 dhe TM3. Në kategorinë paga dhe shtesa janë shpenzuar 2.4 milionë euro, ose 31.6% e buxhetit të kësaj kategorie. Në këtë shumë përfshihet edhe paga e 13-të, e ekzekutuar nga buxheti komunal, për të cilën pritet rimbursim nga niveli qendror. Për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 210 mijë euro, që paraqet ulje prej 57 mijë euro krahasuar me vitin 2025. Kjo reflekton një qasje më të kujdesshme ndaj shpenzimeve, me fokus në nevojat esenciale si mirëmbajtja e rrugëve lokale, ndriçimi publik, sigurimi fizik i objekteve publike dhe furnizimet shëndetësore. Shpenzimet komunale kanë arritur në 72 mijë euro, me rritje si rezultat i kostos së energjisë elektrike dhe zgjerimit të rrjetit energjetik në territorin e komunës. Në kategorinë subvencione dhe transfere janë realizuar 62 mijë euro, të dedikuara për transportin e nxënësve, mbështetjen e OJQ-ve rinore e sportive, ndihma për lehonat dhe për familjet në gjendje të rëndë ekonomike e shëndetësore. Për investime kapitale janë realizuar 451 mijë euro, ose 14% e buxhetit të kësaj kategorie. Realizimi më i ngadaltë lidhet me hyrjen në fuqi të buxhetit dhe procedurat administrative të prokurimit dhe ekzekutimit të projekteve. Për më shumë detaje, raporti i plotë ju është shpërndarë nga Zyra e Kuvendit. Si drejtori, mbetemi të fokusuar në rritjen e të hyrave vetjake dhe monitorimin e realizimit të buxhetit, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për të gjitha drejtoritë komunale.

**z. Islam Gashi:** Ne kemi raportin financiar për TMI të vitit 2026, të cilin nuk duhet ta shohim vetëm si dokument informues, por edhe si mjet për përmirësimin e menaxhimit financiar të komunës. Ky raport ngre disa shqetësime serioze lidhur me cilësinë e planifikimit buxhetor, arkëtimin e të hyrave vetjake komunale (HVK) dhe ritmin e realizimit të investimeve kapitale. Sa i përket planifikimit buxhetor, vërehen dallime të mëdha mes planifikimit dhe realizimit në TMI 2026. Kjo tregon se planifikimi nuk është bazuar në performancën e viteve paraprake, por më tepër në pritje optimiste. Për shembull, te kategoria “taksat tjera komunale”, realizimi i HVK vetëm në TMI 2025 ishte rreth 33.500€. ndërsa planifikimi për tërë vitin 2026 është vetëm 32,000€. Kjo dëshmon për planifikim jo real dhe jo të qëndrueshëm. Te taksat komunale kemi realizim prej 80%, që në pamje të parë duket pozitiv, por krahasuar me vitin e kaluar kemi rreth 7,600€ më pak të hyra. Kjo mospërputhje e bën të vështirë një analizë të qartë të performancës. Sa i përket investimeve

kapitale, realizimi në TMI 2026 është vetëm 14% e buxhetit kapital, përqindje shumë e ulët për tre muajt e parë të vitit. Nëse ky ritëm vazhdon edhe në TM2, rrezikohet që në fund të vitit të kemi realizim shumë të ulët të investimeve kapitale. Kjo mund të krijojë presion për përshpejtim të punëve në periudhat e ardhshme, duke ndikuar negativisht edhe në cilësinë e projekteve dhe shërbimeve. Po ashtu, krahasuar me TMI 2025, kemi rënie të realizimit të investimeve kapitale nga rreth 506 mijë euro në 451 mijë euro, pra rreth 55 mijë euro më pak. Një çështje tjetër lidhet me programin buxhetor “Administrata”, kodi 16328. Në TMI 2025, totali i mjeteve figuron 9,408€, ndërsa shuma e kategorive të listuar arrin vetëm 3,645€, duke krijuar një diferencë prej 5,763€. Për më tepër, edhe pse te secili kod individual ka rritje të hyrave, në total paraqitet rënie. Kjo kërkon sqarim nëse mungon ndonjë kategori apo kemi të bëjmë me gabim në llogaritje. Te kategoria “Certifikatat tjera” në administratë, kemi rritje të madhe nga 313€ në TMI 2025 në 3,055€ në TMI 2026. Kërkojmë sqarim se cilat shërbime përfshihen në këtë kategori dhe cili është shkaku i kësaj rritjeje. Një tjetër element që bie në sy është ulja e përgjithshme e shpenzimeve në kategorinë “mallra dhe shërbime”, ndonëse në disa kode buxhetore ka rritje të shpenzimeve. Sipas raportit, rreth 75,000€ më pak janë shpenzuar për mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Kjo mund të ketë ndikuar në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve ose mund të lidhet me shtyrje pagesash apo vonesa në realizimin e kontratave. Mbetet të shihet në TM2 nëse kemi kursime reale apo vetëm vonesa në shpenzime. Gjithashtu, te kategoria e shpenzimeve komunale vërehet rritje e kostos së energjisë elektrike, si rezultat i sistemit të ri të klimatizimit që ka zëvendësuar ngrohjen me dru. Kam edhe disa pyetje lidhur me kode specifike buxhetore: Kodi 50009 – Taksa për leje ndërtimi: Pse kemi rritje kaq të madhe të hyrave krahasuar me vitin paraprak? Sa leje ndërtimi janë lëshuar dhe a përfshihen në këtë shumë edhe borgje të viteve të kaluara? Kodi 50026 – Taksa për legalizim të objekteve: Sa objekte janë legalizuar gjatë kësaj periudhe krahasuar me vitin e kaluar dhe a ekziston evidencë për objekte ende të paregjistruara? Kodi 50045 – Taksa për leje mjedisore: Pse kemi rënie të theksuar të hyrave? A ka më pak aplikime për leje mjedisore, ndryshim tarifash apo më pak inspektime nga inspektorët?

**z. Valdrin Dogani:** Po filloj me përgjigjet, nisur nga të hyrat, tabela 1 i paraqet në detaje të HVK sipas ligjit të buxhetit. Pastaj të hyrat sipas programeve buxhetore i paraqet të hyrat e inkasuar sipas sistemit të menaxhimit informativ të financave të Kosovës. Këto kode unë i kam klasifikuar të ligji i buxhetit, pasur parasysh që në të ardhmen planifikimi ka me qenë me korrekt, për arsye se raportet e mëparshme kanë qenë në format me ndryshe. Të IK e potencova se kemi pasur mungesë aprovimit të buxhetit, me çka nuk mund të nisim një procedurë pa pasur buxhet dhe nuk mundesh me obliguar një punë kryes me kryer punë. Për shumë pyetje që u ngritën, përgjigje me në detaje, si p.sh. të objektet, të taksat, i japim bashkë me drejtorin e Urbanizimit. Të lejet për ndërtesa, aty klasifikohen edhe taksat për legalizim të objekteve, taksat për leje ndërtimore, me një kod buxhetor, ndërkaq sesa kanë aplikuar, bashkë me drejtorin e Urbanizimit të kthejmë një përgjigje.

**z. Bashkim Krasniqi:** Raporti TMI është një raport që krejt e shohim. Mendoj se ne këtu pajtohemi të gjithë që këto shifra të paraqitura si në raport, të kenë edhe një zero me tepër. Buxheti i aprovuar për vitin 2026 është 13.399,753 €, prej tyre 1,065,138 € të HVK. Kjo tregon shumë se çfarë kapaciteti financiar ka komuna për një periudhë shumë të shkurtër. Si raport nuk mundemi me thënë se është raporti me i miri i mundshëm, por kur të marrim përqindjen e realizimit 25%, del se jemi në hap me realizimin e shpenzimeve. Pyetje për drejtorin, të mirëmbajtja e rrugëve lokale, janë realizuar diku 76 mijë euro në tre kontrata aktive. A mundeni me na ndarë shumën në secilin kod shpenzues buxhetor të këto tre

kontrata aktive të mirëmbajtja e rrugëve lokale, sa mjete janë shpenzuar për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale, sa mjete buxhetore janë shpenzuar për ndriçimin publik dhe sa mjete buxhetore janë shpenzuar për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit vertikal dhe horizontal?

**z. Valdrin Dogani:** Të mirëmbajtja e rrugëve lokale, janë tre kontrata aktive që hynë në kodin ekonomik për mirëmbajtje të rrugëve sipas Ligjit për Rrugët. Për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale, janë shpenzuar 40,992€ për ndriçimin publik 14,232€, për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit vertikal dhe horizontal 20,812€. Islami e pati një numër të madh të pyetjeve, kështu që t' me shkruajnë dhe ia jap përgjigjen për secilën.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Raporti financiar paraqet një pasqyrë jo të kënaqshme të realizimit të buxhetit për TM1, duke evidentuar dështim të theksuar në realizimin e investimeve kapitale dhe stagnim në zhvillimin e projekteve. Shqetësues mbetet niveli i realizimit të investimeve kapitale prej vetëm 14%, ndërsa disa projekte figurojnë me 0% realizim, pra nuk kanë filluar fare. Kjo ngre pyetje thelbësore: kur do të nisnin këto projekte dhe kush mban përgjegjësi për këtë ngecje, veçanërisht në sektorin e bujqësisë ku investimet janë 0%. Si është e mundur që një sektor jetik për zhvillimin ekonomik lokal të mos ketë asnjë investim të realizuar? Edhe në fushën e shërbimeve publike ka projekte me 0% realizim, si rrugët "Qemal Guri" dhe "Ismail Raka", fabrika për trajtimin e ujit të pijes në Sepetin si dhe ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale "Ahmet Kaçiku" dhe projekteve të tjera. Në sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, dy projekte rezultojnë me 0% realizim. Sipas informatave që kam, bëhet fjalë për vendosjen e kioskave në bulevard dhe në pika turistike, ndërkohë që projekti parashihet në vlerë prej 25,000€. Po ashtu, në Drejtorinë e Urbanizmit, projektet për rregullimin e rrugëve në zona urbane dhe rurale, si dhe ndërtimi i kolektorit përgjatë lumenjve Lepenc dhe Nerodime, figurojnë me 0% realizim. Ndërkaq, të mirëmbajtja e rrugëve shihet se nuk ka hezitim në shpenzimin e buxhetit, madje shpesh edhe jashtë kontratave dhe standardeve, siç ka ndodhur gjatë vitit 2025. Kur është paraqitur raporti financiar për vitin 2025, drejtori nuk mi ka dorëzuar kontratat aktive dhe vlerat e tyre, ndërsa kemi kuptuar se ka pasur mungesë të menaxherëve të kontratave, madje në disa raste edhe vetë drejtori ka ushtruar atë rol. Problemi kryesor mbetet mungesa e rezultateve konkrete në terren. Problemi nuk është mungesa e buxhetit, siç po tentohet të arsyetohet situata, por menaxhimi i dobët i kontratave dhe mungesa e llogaridhënies. Po ashtu, dje kam verifikuar në platformën zyrtare të e-prokurimit dhe kam gjetur vetëm një kontratë aktive, atë për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale, të nënshkruar në fillim të janarit. A ekziston kontratë aktive për mirëmbajtjen verore të rrugëve lokale, pasi nuk figuron asnjë kontratë tjetër në e-prokurim? Gjithashtu, a është lidhur ndonjë aneks-kontratë në vlerë rreth 122,000€, e nënshkruar në janar dhe me afat deri në maj 2026?

**z. Valdrin Dogani:** Ernesta edhe me herët e potencova që pa buxhet nuk mundesh me nisur punë. Të gjithë e dimë që me 02 mars është aprovuar buxheti në Kuvendin e Kosovës, ndërkaq mjetet nuk janë alokuar deri në fund të muajit mars. Për këtë arsye nuk mundemi me kërkuar inicim të procedurës të Prokurimi se nuk i kemi mjetet në dispozicion. Kontratat aktive që i kemi nuk mundemi me urdhëruar operatorin me punuar, pa ia dërguar urdhër blerjen, janë procedura që nuk mundemi me iu shmangur. I kemi fjala vjen kioskat, kanë filluar në vitin 2025, kanë qenë me buxhet, është kryer pagesa, pjesa e parë është punuar, tani janë të gatshme për funksionim, por operatori e ka sjellë faturën në muajin prill dhe iu ka paguar në muajin prill. Të e-prokurimi kontrata është e publikuar, por nuk paskeni arritur me i pa krejt kontratat. Në raportin TM2 keni me pa se rriten shpenzimet të kioskat, pagesa

veç është kryer, mundemi me ua dëshmuar edhe ndryshe. Të mirëmbajtja e rrugëve lokale, në krahasim me vitin 2025, kemi ulje të shpenzimeve. Mirë është me bërë fillimisht një krahasim, pastaj me thënë sesa kemi shpenzuar.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Në terren gjërat flasin ndryshe, as pastrimi as mirëmbajtja në krahasim me shpenzimet dhe mirëmbajtja dhe nuk ka qenë e mirë në asnjë vit, nuk ka kontratë që keq menaxhohet me shumë sesa mirëmbajtja e rrugëve lokale.

**z. Valdrin Dogani:** Është shpenzuar aq sa është punuar, nuk ka keq menaxhim të kontratës të mirëmbajtja e rrugëve lokale. Kur të vjen raporti i auditorit e shohim.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Ashtu siç e potencuan edhe kolegët, kur jemi të investimet kapitale, shihet se realizimi i shpenzimeve është vetëm 14%, ndërkaq të HVK janë realizuar 18.7 % e planit vjetor. Ne edhe në KPF e diskutuam se arsyetohet mungesa e aprovimit të buxhetit siç po aludoni ju, por te të HVK, një prej faktorëve për inkasim të ulët të tatimi në pronë ka qenë mungesa e stafit. A është dashur me u iniciuar procedura për plotësimin e stafit që stafi me dalë në terren dhe me vazhduar me inkasuar të HVK.

**z. Valdrin Dogani:** Te të HVK të tatimi në pronë e kam shënuar edhe në raport se deri me 31 mars nuk kemi mundur me shtypur faturën e tatimit në pronë, për qytetarët që kanë qenë të interesuar me paguar për vitin 2026, ka pasur interesim të madh të qytetarëve me i kryer obligimet e tyre, por nuk kemi mundur se tatimi në pronë është i përfshirë në ligjin e buxhetit. Me 01.04.2026 janë bërë faturat. Unë e potencia se pagesat kanë me reflektuar në TM2 dhe TM3 ku kemi me pasur rritje të inkasimit të tatimit në pronë. Sa i përket stafit, mundini me u kyçur në faqen zyrtare, konkursi është hapur për udhëheqës të tatimit në pronë. Edhe në planin e punës së DBF e kam paraqitur se kam me tentuar me angazhuar një kompani për shërbime kontraktuese për rianketim të pronave, që me filluar me tatimin e pronave të reja.

**z. Arian Teneqja:** Po jep përgjigje Ernestës për kontratën e mirëmbajtjes së rrugëve lokale verore dhe dimërore. Shpenzimet e paraqitura janë kryesisht për mirëmbajtje dimërore të rrugëve. Besoj se të gjithë e dini se jemi munduar që mirëmbajtja dimërore e rrugëve është realizuar në formën me të mirë të mundshme, nuk ka pasur probleme. Të mirëmbajtja verore e rrugës, kontratë aktive nuk ka, e kemi iniciuar procedurën e tenderimit, çështja është në procedurë dhe nuk është lidhur ende kontrata. Për shkak të këtyre vonesave dhe procedurës së tenderimit, ne kemi bërë një kontratë të vogël prej 10 mijë euro, që disa gropa emergjente të sanohen. Patëm me herët një kërkesë nga znj. Kadrije për gropat në rrugën "Mynyr Thaqi", ato gropat që janë paraqitur janë në kuadër të kësaj kontrate, besoj se operatori do të rehabilitoj. Gropat janë shënuar me ngjyrë të verdhë, mundeni me i pa ditëve në vijim, dhe kanë me u rregulluar së shpejti në kuadër të kësaj kontrate, për arsye se po penalizohemi shumë nga ligji i prokurimit. Kontrata për mirëmbajtje verore të rrugëve ende është në procedurë dhe se po vonohet shumë për shkak të procedurave. Kontrata kryesore për mirëmbajtje verore të rrugëve ende nuk kemi, pasi të lidhet do të bëhen sanimet e përgjithshme të rrugëve që u përmenden.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Atëherë Raporti nuk është i saktë se në raport thuhet se janë tre kontrata aktive. Edhe drejtori i financave përmendi shpenzimet në shumë 40 mijë euro. Prej cilës kategori është shpenzuar kjo shumë, nga kontrata për mirëmbajtje dimërore të rrugëve apo asaj verore?

**z. Valdrin Dogani:** Shpenzimi ndodhë, klasifikohet me kod ekonomik. Kodi ekonomik, Mirëmbajtja e rrugëve lokale i përfshinë tre kontrata që i kemi; Mirëmbajtja e rrugëve lokale, Mirëmbajtja e Ndriçimit publik, Mirëmbajtjen e sinjalizimit vertikal dhe horizontal.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kontratat nuk janë aktive. Nëse kontrata për mirëmbajtje verore të rrugëve lokale ka qenë aktive, deri në cilën kohë ka qenë aktive?

**z. Valdrin Dogani:** Kontratat kanë qenë aktive në janar-mars-2026, drejtori i shërbimeve publike foli edhe për periudhën pas janar-mars 2026.

**z. Arian Teneqja:** Për mos me marrë kohë me tepër Ernesta, të kodet ekonomike ua sqaron kolegu i juaj Islami.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Sqarimet po dua me i marrë nga ju drejtor.

**z. Arian Teneqja:** Mirëmbajtja verore e rrugëve, kontrata e vjetër ka përfunduar. Mirëmbajtja ka qenë në nivelin e duhur. Për këtë vit për vitin 2026-2027 kemi me bërë kontrata të veçanta të mirëmbajtjes së rrugëve. Për mirëmbajtje verore kontratë e veçantë, dhe për mirëmbajtje dimërore kontratë e veçantë. Të dy kontrata janë në procedurë të prokurimit. Kontrata për mirëmbajtje verore ende nuk është lidhur, është në procedurë të prokurimit. Aktive ka qenë, kontrata për mirëmbajtjen e ndriçimit publik. Kontrata për mirëmbajtjen e sinjalizimit vertikal dhe horizontal -ka qenë aktive për fazën që është raportuar.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Pse nuk po me jepni përgjigje deri kur ka qenë aktive kontrata për mirëmbajtje verore dhe dimërore e rrugëve lokale, sepse në e-Prokurim është kontrata për mirëmbajtje dimërore e rrugëve, ndërsa nuk ka kontratë aktive qysh e keni paraqitur në raport. Në raport thuhet se janë tre kontrata aktive, ndërkaq këtu thuhet se nuk i kemi tre kontrata aktive.

**z. Islam Gashi:** Unë me herët i adresova shumë pyetje, të programi buxhetor administrata 16328 është një devijim i inkasimi i të HVK, nuk e di a është gabim apo çka është në pyetje. Nëse i mbledhim të hyrat në secilin kategori të ky kod buxhetor, del se janë inkasuar 3,645€ në TM1 2025, ndërkaq këtu është shuma 9,408€, një diferencë prej 5,763€. Nëse secilën të hyrë në kodin buxhetor administrata, nëse e analizojmë një nga një të hyrat në këtë kod buxhetor, del se ka pasur rritje të hyrave në TM1 2026, ndërkaq në total po del se ka pasur inkasim me të vogël. A mungon ndonjë kod buxhetor, apo është bërë kalkulimi gabim?

**z. Valdrin Dogani:** Kalkulimi është bërë me programin Exel, Është harruar një shifër këtu. Kërkoj falje, ky është gabim teknik i imi. Të sqaroj me email edhe pyetje nëse i keni, mundësisht me dërgoni në email dhe të jap përgjigjen.

**Kryetari i Komunës: Sabedin Vishi:** Fillimisht i përshëndeti të gjithë ata që iu janë përgjigjur aksionit për pastrimin e tokës më 22.04.2026. Po kyçem në këtë temë me qëllim që të kontribuojë sadopak në diskutim. Planifikimi në TM1 ka qenë më i ulët sesa realizimi, realizimi në TM1 tradicionalisht ka qenë më i ulët, gjë që e dinë edhe ish-anëtarët e Kuvendit Komunal. Ka pasur ngecje në realizimin e shpenzimeve për shkak të aprovimit me vonesë të buxhetit. Lidhur me kontratat, kontrata për mirëmbajtje verore dhe dimërore ka qenë aktive deri në janar, ndërsa sivjet është vendosur që ato të ndahen veçmas, me qëllim të

rritjes së cilësisë dhe efikasitetit në punë. Duke parë se kishte ankesa dhe zvarritje të procedurave të prokurimit, jemi obliguar të lidhim një kontratë tjetër aktive, pasi në rast të reshjeve të borës qytetarët nuk pyesin nëse ekziston apo jo kontrata. Kontrata për ndriçimin publik është aktive, po ashtu edhe kontrata për sinjalizimin, ndërsa vetëm kontrata për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve ka përfunduar dhe aktualisht nuk është aktive. Tani kontratat janë ndarë veçmas: kontrata për mirëmbajtje dimërore është në procedurë dhe ende nuk është lidhur, ndërsa edhe kontrata për mirëmbajtje verore të rrugëve është në procedurë dhe ende nuk është lidhur. Sa i përket shpenzimeve, nëse nuk gabojmë edhe drejtori mund ta korrigjojë, ato mbulohen nga një kod i vetëm buxhetor, ku përfshihen mirëmbajtja e rrugëve, ndriçimi publik dhe sinjalizimi. Në lidhje me rritjen e shpenzimeve të energjisë elektrike, dihen arsyet pse këto shpenzime janë më të larta, duke përmendur rritjen e vazhdueshme të çmimit të energjisë elektrike gjatë viteve të fundit. Nëse kjo rritje vazhdon, ndoshta do të detyrohen të ndërmarrin masa kufizuese. Sa u përket kontratave të tjera, ato janë ende në procedurë. Ndërkaq, për investimet kapitale, ne nuk kanë pasur të drejtë të fillojnë asnjë procedurë deri në muajin mars, për shkak se buxheti nuk kishte qenë i alokuar, kjo situatë na ka penalizuar me një realizim prej 0%. Buxheti është alokuar në prill, pastaj është filluar me procedurat, por procedurat e prokurimit zgjasin, pasi vetëm faza e vlerësimit merr rreth një muaj, e më pas vijojnë afatet për ankesa në OSHP dhe procedura të tjera. Sa i përket të hyrave nga tatimi në pronë, përgjegjësia nuk bie mbi institucionin tonë, pasi faturat e tatimit në pronë janë proceduar me vonesë dhe kanë dalë pas katër muajsh. Mangësi e institucionit është mosplotësimi i stafit, por procedimi i faturave nuk bëhet nga ne. Edhe në këtë rast ka pasur faktorë të tjerë që kanë ndikuar në mos procedimin e faturave dhe rrjedhimisht në mosrealizimin e shpenzimeve për investime kapitale. Në fund po e theksoj se aty ku kanë gabime synojnë të përmirësohen, ndërsa kritikën, qofshin nga anëtarët e kuvendit apo qytetarët, janë të mirëseardhura. Lidhur me pretendimet për keq menaxhim të kontratave, nëse ekzistojnë fakte për parregullsi, ato duhet të adresohen te organet kompetente dhe jo këtu në kuvend.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Të keq menaxhimi i kontratave kemi thënë se pastrimi i trotuareve, kontrata është 10 cent km<sup>2</sup>.

**Kryetari i Komunës:** Nëse ju mendoni se ka keq menaxhim të kontratave, lirisht i dërgoni në organet e pavarura të drejtësisë. Këtu secili e kemi njëfarë përgjegjësie se çka flasim. Nuk është në rregull këtu veç me folur se ka hajni, keq menaxhim, duhet me pasur fakte kur thonë kështu. Këto janë fjalë të rënda, ose ne duhet me shkuar në organe për keq menaxhim ose duhet ju duhet të tërhiqni fjalën.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Nuk e tërheqë fjalën, sepse është keq menaxhim kur i kam thënë drejtorit pse nuk i keni pastruar trotuaret kur 10 cent km<sup>2</sup>, ka thënë se nuk ka buxhet. Në momentin kur e ke nënshkruar kontratën ke të drejtë me i shpenzuar mjetet për çka do që e keni nënshkruar kontratën. Në kontratë shkruan se 10 cent km<sup>2</sup>, që me 10 euro në çdo muaj keni mundur me i pastruar trotuaret. E dyta, ose unë po keq kuptohem se nuk thashë që nuk ka mirëmbajtje të ndriçimit publik dhe mirëmbajtje sipas dy kontratave tjera, unë thashë se nuk kam mundur me i gjetur në e-prokurim. Kërkoj nga ju drejtor të me dërgoni këto dy kontrata, se kontratën për mirëmbajtje dimërore të rrugëve e kam pa. Raporti është fakt që ne duhet me u bazuar. Këtu në raport thuhet se janë tre kontrata aktive, mirëmbajtja verore, hiqeni se në TM1 nuk ka pasur kontratë për mirëmbajtje verore të rrugëve. Në TM2 kur të bëhet kontrata, tani ju kuptojmë dhe ju besojmë se ka me pasur kontratë. Drejtor kërkoj tre

kontratat me mi dërguar, që me i pa çmimet në secilën kontratë, për me ditur çka me iu kërkuar qytetarëve të komunës për mirëmbajtje të rrugëve.

**znj. Ardita Rrahmani:** Për punën e kontratave, ne kemi të drejtë me bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, plotësohet një kërkesë dhe e adresoni. Këtë çështje keni mundur me ngritur të pyetjet dhe kërkesat.

**z. Arian Teneqja:** Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve ka qenë në nivelin e duhur. Me vjen mirë që ankesa e vetme ka qenë të trotuaret, ndërkaq rrugët kryesore si verës ashtu edhe dimrit janë mirëmbajtur mirë. Në të ardhmen do të marrim me prioritet mirëmbajtjen e trotuareve, që të jenë sa me mirë të mirëmbajtura. Kontratat janë publike në e-prokurim, por nuk ka problem, ti dërgoj, se ndoshta keni pasur pengesa në qasje.

**z. Islam Gashi:** Çështjen e planifikimit kryetari nuk e llogariti si kritikë me vend. Unë e kuptoj që realizimi në TMI është i doobët, por të taksat tjera komunale realizimi në TMI 2025 është 33,504€. Pa ditur hiq qysh ka me qenë planifikimi në vitin 2026 e kisha bërë me planifikimin e këtyre të hyrave në vitin 2026 në këtë shumë, ndërkaq për vitin 2026 të taksat tjera komunale janë planifikuar 32,000€. Me arsyetoni pse është pavend kjo kritikë?

**Kryetari i Komunës:** E para, nuk themi se çdo kritikë e keni pavend. Unë thashë për raportin në përgjithësi, ndërkaq nëse keni vërejtje të ndonjë shifër, janë drejtorët, të cilët u zotuan se do të sjellin. Nëse është bërë ndonjë gabim teknik, kërkojmë falje, siç ishte gabimi i një rubrike nga drejtori i DBF dhe keni arsye. Ne kemi me qenë transparentë, se nuk mundemi me iu ikur këtyre. Unë e pata fjalën të planifikimi në përgjithësi. Ne fjala vjen e kemi pritur PZHK për tre vite, ne nuk mundemi me planifikuar inksimin e mjeteve, se nëse leshon një leje ndërtimi, munden me na u rritur të hyrat. Ne mundemi me bërë planifikim me të vogël, me me inkasuar me shumë. Nëse 4 ndërtesa të mëdha nisen sivjet, ne tejkalojmë të hyrat dhe mjetet shkojnë në favor të zhvillimit ekonomik. Të kontratat, ju e dini pse nuk janë realizuar në mënyrën me të mirë të mundur dhe pse nuk janë realizuar shpenzimet dhe cilët janë faktorët.

**z.Valdrin Dogani:** Kur është bërë planifikimi, kam qenë pjesë e planifikimit buxhetor 2026, të tatimi në pronë kemi planifikuar inkasim 478,502€, ndërsa nuk e kemi menduar se do të kemi problem me shtypjen e faturave. Ajo që duhet arritur, ne kemi planifikuar të HVK 1.065,133.00€, kryesorja është kjo me u arritë e me u shfytëzuar këto mjete, e për pjesën e planifikimit mundemi me u përmirësuar. Sa i përket shpenzimeve për investimet kapitale, në vitin e kaluar janë shpenzuar 99.9% e tyre janë realizuar.

**z.Islam Gashi:** Ju po e merri shembull të tatimi në pronë, ndërkaq unë mora këtë kategorinë tjetër, të taksat tjera komunale, ju nëse i keni planifikur 32,000€, po supozojmë keni përfituar 100,000€ të kjo kategori nëse jeni të suksesshëm, por nëse dështon të pjesa e tatimit në pronë, kur të llogaritësh në total, nëse planifikimi nuk është i saktë edhe nuk inkason, atëherë shumë pak keni me dalë të suksesshëm.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Diskutime të tjera nuk ka, Raporti financiar kalon si informatë. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

#### **NJOFTOHET**

**Me Raportin Tremujor Financiar për periudhën: Janar-Mars 2026/ Lënda: 01Nr. 400/01-8999/26.**

3. Propozim Vendim për themelimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusave” SH.A.- Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendi:** Fjalën e ka fillimisht drejtori i DSHPE, Arian Teneqja.

**z. Arian Teneqja:** Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike nenit 5.2, formohet Komisioni do të formohet në përbërje prej 3 anëtarëve, një anëtar caktohet nga Kryetari i Komunës, që në këtë rast iu njoftoj se është caktuar Arben Fera- Ekonomist, ndërsa dy anëtarët tjerë caktohen në KK me shumicë të thjeshtë të votave.

**Kryesuesi i Kuvendi:** E hapi diskutimin, shkojmë me propozime konkrete të subjekteve politike për anëtar të komisionit, duke filluar nga subjekti me i madh politik-PDK.

**Bashkim Krasniqi:** Për Komisionit komunal të aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusave”, për anëtar e propozojmë të jetë, Brahim Imishti-anëtar i KK.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nga LVV e propozojmë për anëtar të komisionit të jetë, Enis Vishi.

**z. Betim Shala:** Nga LDK e propozojmë për anëtare të komisionit të jetë, Arta Berisha Lika.

**z. Kjani Zeneli:** VZHK nuk ka propozim për anëtar të komisionit.

**znj. Hafize Sallahi:** AAK nuk ka propozim për anëtar të komisionit.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Kryesues, sa po e kuptojmë ne, përbërja e komisionit duhet të jetë: një anëtar i propozuar nga kryetari i komunës dhe dy anëtarë të propozuar nga KK. Meqenëse janë paraqitur dy propozime, ato duhet të hidhen në votim dhe nuk duhet të procedohet me propozime të tjera. Nëse vazhdohet në këtë mënyrë, ne do ta tërheqim propozimin tonë, pasi po krijohet përshtypja se nuk ka vullnet për të pasur mbikëqyrje në komisionet e ndërmarrjeve publike. Kjo është e padrejtë, kjo i prekë drejtpërdrejtë qytetarët, dhe këtu nuk do të ketë transparencë në asnjë moment.

**z. Enis Vishi:** Çka bëhet kryesues nëse kalojnë tre propozimet që u dhanë?

**znj. Kadrije Lika Troni:** Kryesues, nëse jeni duke vazhduar me propozimet veç e veç, se këtu thuhet se një anëtar e propozon kryetari dhe dy anëtarë KK, ndërkaq ju po kërkonit shumë propozime. Kjo nuk është ecuri e mirë punës qysh jeni duke vepruar. Kështu që ne LVV e tërheqim kandidatin tonë të LVV, për shkak të parregullsive të procedurës.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Propozimin e subjektit politik të PDK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 12 votë Për, 6 votë kundër-LVV, 3 Abstenime-VZHK. Prezentë 21.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kryesues ju jeni përfaqësues i krejt kuvendit, nuk jeni përfaqësues i vetëm pozitës. Të paktën mësoje ecurinë e votimit. Ia keni mësy me i kapë aksionet publike, me përfaqësues të pozitës.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Meqenëse LVV e kanë tërhequr kandidatin e propozuar të tyre, atëherë shkojmë me anëtarin e propozuar të LDK, Arta Berisha Lika. Propozimin e shtroj

në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 12 votë Për, Kundër 6-LVV, Abstenime 3-VZHK. Prezentë 21. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori

#### VENDIM

Për themelimin e Komisioni Komunal i Aksionarëve, për Ndërmarrjen Publike Komonale "Stacioni i Autobusave" SH.A – Kaçanik, prej tre (3) anëtarëve, si vijon:

1. Arben Fera anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës,
2. Brahim Imishti anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës,
3. Arta Berisha Lika anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës/ Lënda:  
01Nr. 104/02-8821/26.

4. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik i Vjetër;

**Kryesuesi i Kuvendi:** E hapi diskutimin:

**z. Kjani Zeneli:** E para nuk e kuptova a e tërhoqi LVV kandidatin e tyre për anëtar të komisionit. Ne si VZHK do të abstenojmë në këtë pikë, se nuk i kemi shumë të qartë çështjen. Ne atëherë kemi abstenuar se nuk e kemi pas të qartë formën, edhe tani e kemi të njëjtin mendim.

**z. Bashkim Krasniqi:** Kjo parcelë është në Kaçanik të Vjetër nga vijë edhe unë. Unë e kam vizituar këtë parcelë, rruga që figuron këtu nuk ka ekzistuar asnjëherë. KIVO është investitor shumë serioz i komunës tonë, ka shumë të punësuar të komunës tonë, kjo firmë na i ka hapur dyert çdo herë për donacione për klube sportive etj. Drejtori e kishte shënuar se nuk e dëmton interesin publik kjo pronë. Kjo pronë është me interes publik, duke marrë për bazë të gjitha këto që i potencova, mendoj se duhet me u votuar. Ne subjekti politik i PDK jemi Për, që me ia mundësuar KIVO me zhvilluar veprimtarinë e saj pa pengesa.

**znj. Ardita Rrahmani:** Është njëra prej pikave që kam me votuar me shumë krenari dhe kam me mbajtur mend. Për ata që kanë dyshime se cili është interesi i komunës, mjafton me lexuar këtë, se përfitimet janë rritja e kapaciteteve prodhuese, që me rritjen e tyre përfitojnë direkt qytetarët e komunës tonë. Duke ditur sa ka ndihmuar KIVO në mirëqenien sociale të njerëzve të kësaj komune, për mua do të ishte absurde të votohet ndryshe. Pos tjerash, komuna i përfiton me tepër sesa jep pronë.

**z. Kjani Zeneli:** Unë e keqkuptova, se mendova që është pika e pestë, kështu që e tërheqë mendimin që e potencova fillimisht. Ne subjekti politik i VZHK e përkrahim plotësisht miratimin e kësaj pike.

**z. Jeton Luma:** Kompania KIVO është dëshmuar si kompani serioze dhe e përgjegjshme për veprimtarinë e saj. Ne si LVV e përkrahim kompaninë e vendit, në këtë rast të komunës tonë të cilat kontribuojnë direkt në zhvillimin ekonomik dhe punësimin e qytetarëve të komunës tonë. Ne e mbështetim këtë këmbim, vetëm duhet të sigurohemi nga drejtori se materiali është krejt në rregull që mos të vjen puna me na u kthyer qysh ka ndodhur në disa nga rastet tjera që janë kthyer për çështje procedurale e teknike. Ne subjekti politik i LVV do të votojmë Për.

**znj. Ardita Rrahmani:** Është për me u duartrokatur vendimi i LVV, pasi që për herë të parë e votojmë një këmbim të pronave. Kur të votohet kjo pikë kam me u ngritur në këmbë dhe me duartrokatur.

**z. Korab Krasniqi:** Nuk dua të me ikur ky rast pa e marrë fjalën, kur edhe L.VV përkrahë diçka.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtor, mundësisht të diskutojmë rreth pikës.

**z. Korab Krasniqi:** Besoj se këtë qasje duhet me pasur edhe në raste tjera kur kërkohet këmbim i pronës, pasi të gjitha propozimet që kanë ardhur në KK kanë qenë në të mirë të personave fizik apo të personave juridik. Kompania kur e ka blerë pronën, nuk ka pasur rrugë aty. Po e paraqes edhe në formë vizuale për me kuptuar me mirë pronën që shpallet me interes.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Drejtor, kur janë punët e mira, këmbimet e mira që kanë interes komuna dhe qytetarët, votojmë në mënyrë solemne. Ky është mësim për ju sesi me i sjellë këto prona. E mora fjalën pa me dhënë kryesuesi, se nuk po e bënë përfaqësimin si duhet.

**z. Korab Krasniqi:** Faleminderit për komplimentin, lënda është e përgatitur mirë. Shikoni në formë vizuale ku është rruga që e ka hapur KIVO, tani me marrjen e parcelës tjetër e shoh të nevojshme zgjerimin e rrugës dhe ndërtimin e një objekti të ri. Këtë e ka kërkuar nga DUKMM që me u bërë rruga tjetër e re në pjesën e djathtë, besoj se i plotëson të gjitha kushtet me u shpallë fillimisht zonë me interes, pastaj me u realizuar këmbimi. Ju falënderoj të gjithëve për qasjen pozitive që keni në këtë rast.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 21. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Shpallje me interes publik të Parcelës Kadastrale 02301-0, pjesën e parcelën në sipërfaqe 1273m<sup>2</sup> në ZK Kaçanik i Vjetër, në pronësi të personit Juridik "KIVO" L.L.C, për krijimin e një rruge të re/ Lënda: 01Nr. 104/02-8864/26.**

**znj. Ardita Rrahmani:** Me vjen mirë që pati unitet në këtë çështje, vendimet e KK është një organ mbikëqyrës që i shqyrton se a janë në rregull. Asnjë dokument që ka ardhur në këtë mandat dhe mandatin e kaluar për këmbim të pronave nuk ka është votuar njëzëri.

5. Propozim Vendim për Plotësim Ndryshimin e Vendimit 01Nr. 104/02-4196/26 të datës 26.02.2026, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Faik (Rufat) Muça;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Kjani Zeneli:** Nëse mundet drejtori me na sqaruar pse është kthyer lënda nga ministria?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Fjalën e ka drejtori i drejtorisë për sqarime.

**z. Korab Krasniqi:** Nga ministria është kërkuar një dëshmi shtesë se kush menaxhon me rrugët publike të pa kategorizuara. Në raste normale MAPL nuk është dashur me kthyer vendimin.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Çështja është se ministria për dy vendime të njëjtës natyrë, njërën e ka kthyer pozitiv, këtë negativ.

**z. Korab Krasniqi:** Ne për me plotësuar lëndën, e kemi bërë një njoftim nga DUKMM, që me i njoftuar qytetarët, personat fizik dhe personat juridik dhe institucionet relevante, se në përputhje me legjislacionin në fuqi, ligji për pronë publike Nr. 08/L-125 neni 26 pika 1, nën-pika 1.8 komuna ushtron kompetencën e saj për menaxhimin dhe administrimin e pronave të kategorisë P.SH.- Rrugë publike të pa kategorizuara brenda territorit të saj administrativ.

**z. Kjani Zeneli:** Unë nuk pajtohem me fjalët që i tha drejtori. E para, shikoni formën se qysh na është përcjellë materiali. Me pas qenë në rregull këmbimi i pronës, MAPL nuk kishte kthyer dhe me kërkuar dokumente shtesë. Pikën 4 e mbështetëm, se ishte në rregull, KIVO është firmë serioze, ndërkaq të kjo pikë ka mangësi diçka dhe nuk e mbështetim.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Kur është aprovuar këmbimi i këtyre pronave, ne kemi votuar kundër, ndërkaq tani ne subjekti politik i LVV nuk marrim pjesë në votim.

**z. Betim Shala:** Edhe unë mendoj njëjtë si drejtori, se me rrugët publike të pa kategorizuara dihet se menaxhon komuna, përpos rrugëve magjistrale që lidhin dy komuna, menaxhon ministria. Sa i përket këmbimit, mendoj se është e nevojshme për lagje me u bërë ky këmbim. Ne e dimë se pronari i tokës ku bëhet këmbimi, edhe rrethojën e ka me brenda sesa ku është kufiri i duhur, mendoj se duhet me kaluar ky këmbim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin për Plotësim Ndryshim të vendimit 01Nr. 104/02-4196/26 e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 12 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 3 -VZHK, nuk morën pjesë në votim 6 - LVV. Prezentë 21. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori

#### VENDIM

**Për Plotësim Ndryshimin e Vendimit 01Nr. 104/02-4196/26 të datës 26.02.2026, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Faik (Rufat) Muça/ Lënda: 01Nr. 104/02-9750/26.**

Ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit bëhen të pika 4, i shtohet paragrafi 4.1 me tekstin si vijon: “Me pronat publike “P.SH Rrugët Publike dhe të pakategorizuar” brenda territorit të Komunës së Kaçanikut, menaxhon Komuna e Kaçanikut”.

Mbledhja i përfundoj në ora 12:35. Deri në fund të mbledhjes ishin të gjithë anëtarët-21.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

*Malsiu*



Kryesues i Kuvendit  
Selajdin Troni

*Troni*

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 12 Tetorit 2025);**

**Në mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të Kuvendit të Komunës,**  
**(Legjislatura e 8 e KK), për vitin 2026, mbajtur me 30.04.2026:**

1. Selajdin Troni.....,
2. Blerim Koxha.....,
3. Xhelal Ceka .....,
4. Brahim Imishti .....,
5. Bashkim Krasniqi,.....,
6. Lejla Muhaxheri Çaka .....,
7. Elona Gjini.....,
8. Shqipe Murseli .....,
9. Enis Vishi.....,
- 10.Kadrije Lika Troni.....,
- 11.Ernesta Krasniqi .....,
12. Islam Gashi .....,
13. Buletin Guri .....,
14. Jeton Luma .....,
15. Betim Shala .....,
- 16.Samedin Rexha,.....,
17. Ardita Rrahmani .....,
18. Heset Malsiu .....,
19. Kijani Zeneli .....,
20. Lejla Luta .....,
21. Hafize Sallahi,.....,



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

DATA:	20.05.2026
PËR/ZA/TO:	KUVENDIN KOMUNAL-KAÇANIK
NGA/OD/FROM:	Arian TENOQJA Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje ndaj pyetjeve dhe kërkesave nga mbledhja e IV e rregullt e Kuvendit Komunal

**Jeton Luma:**

3. Ndriçimi publik në f. Gllaboçicë

Edhe pse disa shtylla janë rregulluar, një pjesë e ndriçimit publik mbetet jashtë funksionit, veçanërisht përgjatë rrugës “Batalioni III”. Kërkoj të bëhet riparimi i plotë i ndriçimit në këtë zonë.

**Përgjigje:** Defektet në ndriçimin publik në rrugën “Batalioni i III-të”, siç ju kam njoftuar, kanë qenë në proces sanimi dhe tani janë rregulluar.

**Bashkim Krasniqi:**

1. Nga banorët e f. Begracë kërkohet ndërtimi i një rrethrotullimi në mes të shkollës dhe xhamisë, pasi zona frekuentohet nga nxënësit dhe paraqet nevojë për rritjen e sigurisë në komunikacion.
2. Kërkesa tjetër është: Kyçja në rrugën te Varrezat e Dëshmorëve nga drejtimet Kačanik i Vjetër, Stagovë dhe Dubravë paraqet rrezik të madh. Edhe pse janë krijuar rrugë alternative, kërkohet që komuna të bëjë një kërkesë zyrtare në Ministrinë e Infrastrukturës për një zgjidhje më të sigurt, si ndërtimi i rrethrotullimit, nënkalimit apo mbikalimit.

**Përgjigje 1:** Me lidhjen e kontratës “Mirëmbajtja Verore e Rrugëve Lokale”, e cila është në procedurë prokurimi, do të intervenohet në rrugën kryesore të fshatit Begracë dhe, me këtë rast, edhe me ndërtimin e një vendndalimi të autobusëve, i cili mundëson edhe kthimin e autobusëve për drejtimin e kundërt.

**Përgjigje 2:** Kjo kërkesë është e arsyeshme, mirëpo magjistralja është kompetencë e nivelit qendror dhe, për rimodelimin e kyçjeve dhe zgjidhjen e këtyre kryqëzimeve me rrugë magjistrale, do të bëhet kërkesë në Ministrinë e Infrastrukturës për krijimin e formës së zgjidhjes më të përshtatshme.

### **Ardita Rrahmani:**

Pas konsultimeve me qytetarë dhe shqyrtimit të kërkesave të tyre, parashtroj këto pyetje dhe kërkesa:

1. E ripërsëris kërkesën për shtimin e kamerave të sigurisë në zonat me dukshmëri të ulët, si në qytet ashtu edhe në fshatrat përreth. Duke qenë se komuna është përgjegjëse për infrastrukturën, ndërsa menaxhimi dhe mbikëqyrja bëhen nga Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht policia, kërkoj që kjo çështje të trajtohet me prioritet.
2. Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike: Kërkohe mirëmbajtja e trotuareve dhe rregullimi i ndriçimit publik të dëmtuar në zonat urbane dhe rurale.
3. A janë zhvilluar kohët e fundit takime me kompaninë e ujësjellësit “Bifurkacioni” për të adresuar problemet me furnizimin me ujë të pijshëm gjatë sezonit veror? Në takimin e fundit (ku kam qenë edhe unë e pranishme), është premtuar përmirësim i situatës.
4. Për Drejtorinë e Urbanizmit: Kur pritet të fillojë sanimi i kubëzave në rrugën “Ismail Qemali”?
5. Pas shpalljes së rrugës me interes publik, kur do të fillojë lidhja infrastrukture ndërmjet lagjes së Çakëve dhe qytetit?
6. Në lidhje me vijën kufizuese ndërmjet komunave të Kaçanikut dhe Ferizajt: A është sqaruar përfundimisht vendndodhja e saj? Së fundmi është vendosur një shenjë përtej restorantit “Evropa 92”, e cila, sipas njohurive të mia, nuk përputhet me kufirin real. A keni pasur konsultim me Komunën e Ferizajt për këtë çështje?

**Përgjigje 1:** Komuna është duke implementuar aktualisht një projekt për shtimin e kamerave të sigurisë nëpër rrugët kryesore të qytetit, për rritjen dhe kontrollin e sigurisë.

**Përgjigje 2:** Me lidhjen e kontratës “Mirëmbajtja Verore e Rrugëve Lokale” dhe kontratës së “Mirëmbajtjes së Ndriçimit Publik”, të cilat janë në procedurë prokurimi, do të intervenohet në mirëmbajtjen e trotuareve dhe rregullimin e ndriçimit publik të dëmtuar në zonat urbane dhe rurale.

**Përgjigje 3:** Komuna e Kaçanikut, gjegjësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike, duke u bazuar në buxhetin komunal, ka iniciuar një procedurë për tenderimin e projektit “**Ndërtimi i rezervuarëve, stacionit të pompimit dhe rrjetit të ujësjellësit në Dushkaj – Kaçanik**” dhe së shpejti do të lidhet kontrata. Vlera e investimit është 175,000.00 €. Në këtë projekt përfshihet ndërtimi i një rezervuari me kapacitet 200 m<sup>3</sup> në Dushkajë, i cili do të furnizojë Dushkajën dhe lagjet përreth, duke e shkëputur nga pjesa tjetër e qytetit. Me këtë rast kemi rritje të kapacitetit furnizues për pjesën tjetër. Gjithashtu, pjesë e këtij projekti është edhe shfrytëzimi i pusit të fabrika e ish-Gëlqeres, duke i vendosur pompat që do të furnizojnë rezervuarin kryesor të qytetit. Ne mendojmë se me këtë projekt do të kemi përmirësim të dukshëm të furnizimit me ujë gjatë muajve të pikut të verës, kur kemi probleme me furnizim.

### **Islam Gashi:**

1. Kërkesa e parë lidhet me ndërtimin e parkut në fshatin Begracë, i cili ka filluar vitin e kaluar, por që nga muaji dhjetor nuk është vërejtur asnjë progres në punime. Kërkojmë të na informoni për arsyet e ndërprerjes së punimeve, kohën e planifikuar për rifillim, si dhe nëse ekziston një afat i përcaktuar për përfundimin e projektit.
2. Kërkesa e dytë paraqitet në emër të banorëve të disa lagjeve në fshatin Begracë dhe ka të bëjë me kanalizimin fekal. Megjithëse rrjeti i kanalizimit është ndërtuar në pjesën më të madhe të fshatit, disa shtëpi ende nuk janë të kyçura në rrjetin kryesor. Duke marrë parasysh këtë situatë, kërkojmë që të shqyrtohet mundësia e kyçjes së këtyre shtëpive,

me qëllim të parandalimit të kundërmimit dhe përmirësimit të kushteve të jetesës së banorëve.

**Përgjigje 1:** Punimet te parku në Begracë janë në kuadër të projektit “Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokacionet Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec”. Punimet kanë filluar vitin e kaluar dhe afati për kryerjen e tyre ka qenë 70 ditë, mirëpo, për shkak se gjatë implementimit ka pasur disa pakënaqësi nga disa banorë në lidhje me dizajnin e projektit dhe organizimin e hapësirave të parkut, punimet janë ndërprerë nga banorët deri në shqyrtimin dhe analizimin e kërkesave të tyre, të paraqitura pas fillimit të punimeve. Këto e kanë vonuar dinamikën dhe, rrjedhimisht, sezona dimërore e ka pamundësuar zhvillimin e punimeve. Punimet kanë rifilluar këtë vit dhe së shpejti pritet të finalizohen.

**Përgjigje 2:** Ne kemi përfunduar projektin e kanalizimit kryesor të fshatit Begracë. Rrjedhimisht, tani pa rrjet kanë mbetur disa degëzime të shkurtra sekondare dhe ato shtëpi që janë shtuar pas kryerjes së projektit në fjalë. Këto do të rregullohen sipas prioriteteve dhe rëndësisë në vazhdim, në bazë të kontratës aktive që e kemi “Ndërtimi i Kanalizimeve Fekale dhe Atmosferike”.

#### **Heset Malsiu:**

1. Kërkoj që zona e Shtrezovicës të shpallet me interes publik për ndërtimin e një parku rekreativ, i cili do të përfshijë shtigje ecjeje dhe fusha sportive (tenis, pingpong dhe futboll). Ky park do të shërbejë për fshatrat Biçec, Nikë, Rekë, Dubravë, Vatë dhe Soponicë, pa nevojë për përdorim të automjeteve, si dhe për të gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut.

Kjo kërkesë bazohet edhe në rëndësinë historike të kësaj zone, si vend i ngjarjeve të 25 majit në rajonin e Kaçanikut, ku janë shpëtuar shumë jetë, ndaj vlerësoj se meriton trajtim të veçantë publik.

2. Nga sugjerimet e shefit të grupit të PDK-së për dalje në terren, vizituam Begracën dhe konstatuam se ndërtimi i parkut ka sjellë përmirësim urbanistik, por njëkohësisht ka bllokuar një rrugë lokale të fshatit. Kërkojmë që kjo çështje të shqyrtohet dhe të gjendet një zgjidhje adekuate.

**Përgjigje 1:** Ndërtimi i parqeve dhe hapësirave rekreative dhe sportive janë pjesë e programit tonë qeverisës. Lokacionet e parapara sipas programit tonë do të realizohen gjatë mandatit. Gjatë këtij viti do të ndërtohen terrene sportive në fshatin Kovaçec dhe fshatin Stagovë.

**Përgjigje 2:** Ankesën tuaj në lidhje me qasjen në rrugën në fjalë e kam adresuar te menaxheri i projektit. Zhvillimet në atë rrugë kanë të bëjnë me punimet e parkut dhe ajo do të rregullohet. Edhe nëse kemi rrugë të bllokuar nga shkaqe tjera, gjithsesi se do të trajtohet nga zyrtarët përkatës.

#### **Ernesta Krasniqi:**

2. Në rrugën “Komandant Bardhi” në Kaçanik të Vjetër, ndriçimi publik ka kohë që nuk punon deri te shkolla “Qamil Ilazi”. Besoj se është ndonjë defekt, pasi që pjesa tjetër e ndriçimit publik përgjatë rrugës funksionon. Kërkoj nga drejtoria përkatëse.

**Përgjigje 2:** Me lidhjen e kontratës së “Mirëmbajtjes së Ndriçimit Publik”, e cila është në procedurë prokurimi, do të intervenohet në mirëmbajtjen dhe rregullimin e ndriçimit publik në lokacionet ku kemi defekte.

**Kadrije Lika Troni:**

2. Pyetja e dytë është për Drejtorinë e Urbanizmit: Rruga “Mynyr Thaçi” në f. Kovaçec, nga objekti i Pastërtisë deri te kryqëzimi me rrugën “Izahir Troni”, është e dëmtuar, me gropa të shumta, gjë që pengon qarkullimin e lirë të qytetarëve. Mungon trotuari dhe ndriçimi publik, duke rrezikuar sigurinë e banorëve. Në afërsi të pllakës së dëshmorëve kalon një përrua, pa mbrojtëse anësore, që paraqet rrezik të shtuar për këmbësorët dhe automjetet. Kërkoj nga ekzekutivi të planifikojë rehabilitimin e rrugës, ndërtimin e trotuarit dhe ndriçimit publik, vendosjen e mbrojtëseve anësore përgjatë përroit dhe të sqarojë afatin kohor për realizimin e këtyre ndërhyrjeve.

**Përgjigje 2:** Në lidhje me gropat në rrugën lidhëse nga rruga “Hamëz Jashari” – objekti i KRM “Pastërtia”, rruga “Mynyr Thaçi” në f. Kovaçec, pjesa e gropave do të sanohet ditët në vijim në saje të një kontrate me vlerë të vogël, të cilën e kemi lidhur për sanimin urgjent të disa gropave në rrugët kryesore.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
**Komuna e Kaçanikut**  
Opština Kaçanik/ Municipality of Kaçanik



REFERENCË	
DATË	19/05/2026
PËR/ZA/TO:	Kuvendi Komunal Kaçanik
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Valdrin Dogani Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje ndaj pyetjeve të parashtruara nga anëtarët e Kuvendit Komunal



**Të nderuar,**

Përmes kësaj shkrese, i përgjigjem pyetjes nga znj. Kadrije Lika Troni, anëtare e Kuvendit Komunal, pyetje e parashtruar në mbledhjen e datës 30 prill 2026.

Lidhur me përgjigjen paraprake për numrin e bursave të ndara, pas verifikimit shtesë të raporteve në SIMFK dhe listave të pagesave të realizuara përmes Thesarit, është konstatuar se numri i saktë i përfituesve të bursave komunale (vitit 2025) është 45 (dyzet e pesë), dhe jo 46 siç kam thënë fillimisht.

Keqinterpretimi ka ardhur si rezultat i paraqitjes së një transaksioni teknik në evidencat e pagesave, ku për një rast janë evidentuar dy lëvizje financiare: debi në vlerë prej 250.00 € dhe kredi/stornim në vlerë prej 250.00 € (të shënuara me ngjyrë të verdhë në tabelarin bashkëngjitur). Pagesa fillimisht ishte ekzekutuar gabimisht në një llogari bankare jo të përfituesit, bazuar në të dhënat/konfirmimin bankar të dorëzuar nga përfituesja, ndërsa më pas, pas evidentimit të mospërputhjes ndërmjet emrit të përfituesit dhe llogarisë bankare, mjetet janë kthyer/stornuar përmes Thesarit.

Pagesat për përfituesit e bursave, të ekzekutuara nga Departamenti i Thesarit përmes formës “Pagesa me lista – formë elektronike”, janë realizuar më datë 12 qershor 2025. Ndërsa, pas njoftimit nga Thesari (bashkëngjitur komunikimi me Departamentin e Thesarit) për kthimin/stornimin e mjeteve, pagesa për përfituesin përkatës është realizuar në mënyrë të rregullt nga organizata jonë buxhetore më datë 04 korrik 2025 (e shënuar me ngjyrë të gjelbër në tabelarin bashkëngjitur).

Për këtë arsye, në listën e transaksioneve figurojnë 46 rreshta/ transaksione, dhe përgjigja fillestare e imja është bazuar në këtë numër. Mirëpo, pas verifikimit shtesë është konstatuar se njëri rast përfaqëson vetëm korrigjim teknik të pagesës (debi – kredi), dhe jo përfitues shtesë të bursës.

Ju njoftoj se komuna gjatë vitit realizon me mijëra pagesa dhe transaksioneve financiare, andaj në raste të caktuara mund të ndodhin lëshime teknike apo keqinterpretime.

Po ashtu, në përputhje me [Rregulloren Nr. 06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve](#) (neni 15, pika 3), si dhe me Vendimin e Kryetarit të Komunës për ndarjen e bursave, është përcaktuar qartë se studentët të cilët janë përfitues të bursave nga niveli qendror nuk mund të përfitojnë njëkohësisht edhe bursë nga Komuna e Kaçanikut.

Bashkëngjitur gjeni komunikimet nga Departamenti i Thesarit dhe raportin e nxjerrë nga SIMFK, të cilët dëshmojnë transaksionet e përmendura.

Ju kërkohet falje për keqinterpretimin fillestar dhe ju njoftoj se numri përfundimtar dhe i saktë i përfituesve të bursave komunale është 45.

*Me respekt!*

Kthim i pageses

**LT** Lirije Tahiri  
To: Valdrin Dogani  
Cc: Xhevdet Ferati; Hyrije Shatri  
You replied to this message on 6/18/2025 3:31 PM.

I nderuar,

Ju njoftoj se pagesa sipas kuponit të shpenzimit (EV) ne listën më poshtë, është kthyer nga banka komerciale ose është refuzuar nga sistemi RTGS-BQK, për arsye të llogarisë jo të saktë apo emrit të përfituesit.

Data e kthimit	Përfituesi/Refer. E kthimit	Shuma e pageses	pershkrimi	nr i referenses	Numri i Kuponit Shpenzimit	O.B
16.06.2025		250.00	RETN: ERBLINE ÇAKA. 4176798. LLog nuk perputhet me emrin	4176798	2025-203351	KACANIK

Me respekt



**Lirije Tahiri**  
Zyrtare e Lartë Financiare e Pagesave  
Thesari i Kosovës  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve  
Republika e Kosovës

PHONE +383 38 200 34 059 +383  
MOBILE  
EMAIL [lirije.tahiri@rks-gov.net](mailto:lirije.tahiri@rks-gov.net)  
Adresa: Sheshi Nënë Tereza Ndërtesa Qeveritare, 10000, Prishtinë

Nr. Biliku kodues	Data e KD	Përfutuesi/Klienti/Emri i bankës	Obligim/Zotim	Prd.	Origjina	Numri i dokumentit burimor	Pëshkrim	Debi	Kredji	Rec. Seria e gjetut
1	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203309	KADRI OSIMANI	250.00	0.00	Jo
2	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203311	ELION SHEHU	250.00	0.00	Jo
3	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203312	VERA LUZHA	250.00	0.00	Jo
4	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203314	DIELZA BAFITU	250.00	0.00	Jo
5	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203315	PRANVERA BRRUTTI	250.00	0.00	Jo
6	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203316	MUSTAF ISMAILI	250.00	0.00	Jo
7	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203317	SHKELZEM DEMA	250.00	0.00	Jo
8	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203318	ALBIN DARDHISHTA	250.00	0.00	Jo
9	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203319	GRESE AHMETAJ	250.00	0.00	Jo
10	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203322	ELMA JEZERC	250.00	0.00	Jo
11	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203323	ANITA DENA	250.00	0.00	Jo
12	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203324	LAZIME BURRNIKU	250.00	0.00	Jo
13	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203325	ADEA KUKA	250.00	0.00	Jo
14	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203326	ARDIT ZHARKI	250.00	0.00	Jo
15	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203327	HYSNJUE TOPALLI	250.00	0.00	Jo
16	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203329	EDISA BUSHI	250.00	0.00	Jo
17	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203330	SARA BELA	250.00	0.00	Jo
18	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203331	ARXHENDA SHEHU	250.00	0.00	Jo
19	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203332	VALEZA ZHARKU	250.00	0.00	Jo
20	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203333	ALBIN BULLUPI	250.00	0.00	Jo
21	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203334	ARTA LUZHA	250.00	0.00	Jo
22	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203335	DAFINA SOPA	250.00	0.00	Jo
23	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203336	ENDRIT ZYLQIF LOKU	250.00	0.00	Jo
24	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203337	GZIME LIKA	250.00	0.00	Jo
25	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203339	LIRDONA BELA	250.00	0.00	Jo
26	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203340	DINETA SHORRA	250.00	0.00	Jo
27	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203341	ARNISA GASHI	250.00	0.00	Jo
28	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203342	FITORE KRASNIQI	250.00	0.00	Jo
29	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203343	AGNESA REXHA	250.00	0.00	Jo
30	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203344	ERMIRA BRATI	250.00	0.00	Jo
31	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203345	ALBIONA PALLOSHI	250.00	0.00	Jo
32	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203347	ALBIONA VISHI	250.00	0.00	Jo
33	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203348	JENUZ YARDARI	250.00	0.00	Jo
34	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203349	ELDA MEZINI	250.00	0.00	Jo
35	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203350	ARIANA LIKA	250.00	0.00	Jo
36	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203352	GRESA SHIEHU	250.00	0.00	Jo
37	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203353	RINA RREBA	250.00	0.00	Jo
38	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203354	YLLKA TAFILI	250.00	0.00	Jo
39	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203355	ARBURON TOPALLI	250.00	0.00	Jo
40	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203356	VLERA TOPOJANI	250.00	0.00	Jo
41	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203357	EURON BRUTI	250.00	0.00	Jo
42	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203358	MEDINA BELA	250.00	0.00	Jo
43	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203359	BLERTA BURRNIKU	250.00	0.00	Jo
44	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-203359	ERLINE CAKA	250.00	0.00	Jo
45	10/652/921/40/21200/00000/0980	PAGESA ME LISTA FORME ELEKTRON	2025-110146	QERSHOR	Kupon i shpenzimit	2025-210817	ERLINE CAKA	250.00	0.00	Jo
45	10/652/921/40/21200/00000/0980	ERLINE CAKA	2025-131717	KORRIK	Kupon i shpenzimit	2025-231484	#65292140 SUBVENCIONE PER ETNITETE JOPUBLIKE	11,500.00	250.00	Jo
Totali për Valutë EURO ( € )								11,500.00	0.00	
Totali për Valutë EURO ( € ) (Debi - Kredji)								11,500.00	0.00	



Republika e Kosovës



Komuna Kaçanik

## Drejtoria e Arsimit

---

Për: Anëtarin e Kuvendit: Jeton Luma

Lënda: Përgjigje

Ju falënderojmë për ngritjen e kësaj çështjeje me rëndësi për nxënësit e fshatit Gllboçicë, respektivisht lagjeve Kodrali dhe Dragomac.

Drejtoria e Arsimit e vlerëson me seriozitet nevojën për sigurimin e transportit të nxënësve, duke pasur parasysh rëndësinë e qasjes së barabartë në arsim dhe vështirësitë me të cilat përballen familjet e kësaj zone.

Lidhur me kërkesën e paraqitur, ju njoftojmë se çështja do të shqyrtohet në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse komunale, duke analizuar gjendjen në terren, distancën, numrin e nxënësve dhe nevojat reale për transport. Njëllojësisht, do të vlerësohen mundësitë buxhetore dhe alternative për trajtimin e kësaj kërkesë në përputhje me prioritetet dhe kapacitetet financiare të komunës.

Mbetemi të përkushtuar që brenda mundësive institucionale dhe ligjore, të kontribuojmë në krijimin e kushteve sa më të mira për vijimin e rregullt të procesit mësimor për të gjithë nxënësit.

Me respekt,

**Gazmend Bunjaku**  
Komuna e Kaçanikut  
Drejtor i Arsimit

038 /200-46 438 & 044 224 861

[gazmend.bunjaku@rks-gov.net](mailto:gazmend.bunjaku@rks-gov.net)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Kaçaniku  
Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipality of Kačanik

Kaçanik, 18.05.2026

**Për:** Anëtarët e Kuvendit/ z.Boletin Guri

**Lënda: Informim lidhur me ndërtimin e terrenit sportiv rekreativ në fshatin Nikaj**

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,

I nderuar z.Boletin Guri,

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Kaçanikut informon qytetarët se është paraparë ndërtimi i një terreni sportiv rekreativ në fshatin Nikaj, në kuadër të planifikimeve zhvillimore të kësaj Drejtorie.

Ky projekt është pjesë e prioritetëve të komunës për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive, me qëllim të krijimit të hapësirave të përshtatshme për aktivitete sportive dhe rekreative për të rinjtë dhe banorët e komunitetit lokal.

Në përputhje me planifikimet strategjike dhe mundësitë buxhetore të Komunës së Kaçanikut, realizimi i këtij projekti pritet të bëhet brenda mandatit aktual qeverisës, duke respektuar procedurat ligjore dhe administrative në fuqi.

Me respekt,

Lulzim Krasniqi  
Drejtor i DKRS